

LIGJ
Nr.7708, datë 18.5.1993

PËR KRIJIMIN E URDHRIIT TE MJEKËVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Për të ruajtur cilësinë e lartë të shërbimit shëndetësor dhe për të siguruar zbatimin e rregullave të moralit e të etikës mjekësore krijohet Urdhri i Mjekëve.

Neni 2

Urdhri i Mjekëve përbëhet nga mjekët që praktikojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbushin kushtet për të qenë anëtar sipas këtij ligji.

Neni 3

Asnjë person nuk mund ta ushtrojë profesionin e mjekut në Republikën e Shqipërisë pa qenë anëtar i Urdhrit të Mjekëve, me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin e katërt të këtij neni.

Anëtarë të Urdhrit të Mjekëve janë individët që kanë diplomë mjeku të marrë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, ose në një shkollë të lartë mjekësore të njohur nga Urdhri i Mjekëve, dhe që pranojnë kodin e deontologjisë e rregullat e moralit e të etikës mjekësore.

Mjekët që praktikojnë mjekësinë në Republikën e Shqipërisë dhe që i plotësojnë këto kërkesa në ditën që ky ligj hyn në fuqi, janë anëtarë të Urdhrit të Mjekëve.

Shtetasit e huaj që dëshirojnë ta ushtrojnë profesionin e mjekut në Republikën e Shqipërisë, i nënshtrohen regjistrimit të përkohshëm a të përhershëm, pa u bërë anëtarë të Urdhrit të Mjekëve.

Neni 4

Urdhri i Mjekëve drejtohet nga këshilli kombëtar, i cili përbëhet nga 21 persona. Në këshillin kombëtar ka nga një përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Akademisë së Shkencave dhe Fakultetit të Mjekësisë, të cilët përcaktohen nga titullarët e institucioneve përkatëse. Anëtarët e tjerë të këshillit kombëtar zgjidhen me votim të përgjithshëm të anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve. Zgjedhjet e përgjithshme bëhen çdo 3 vjet.

Neni 5

Këshilli kombëtar harton rregullat e moralit dhe të etikës mjekësore në përputhje me standartin ndërkombëtar dhe traditat e vendit tonë. Ai përgatit kodin e deontologjisë, i cili miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli kombëtar cakton kuotat e anëtarësisë, organizon vjeljen e tyre dhe zbaton buxhetin e Urdhrit të Mjekëve.

Neni 6

Këshilli kombëtar përgjigjet për zbatimin e kodit të deontologjisë dhe të rregullave të moralit

të etikës mjekësore. Ai cakton një komision disiplinor për të hetuar e shqyrtuar shkeljet e kodit të deontologjisë nga anëtarët e Urdhrit të Mjekëve.

Para se të vendosë për dhënien e një mase, komisioni disiplinor dëgjon dhe shqyrton të gjitha faktet për shkeljen e kryer.

Anëtari ka të drejtë të njoftohet për datën e seancës dhe të paraqitet vetë para komisionit për të dhënë shpjegime. Të gjitha faktet e paraqitura dhe shpjegimet e dhëna fiksohen hollësisht e saktë në procesverbal.

Kur komisioni disiplinor, në bazë të fakteve dhe provave të administruara në seancë dëgjimore, vërteton se anëtari ka kryer shkeljen, mund të japë një ose disa nga këto masa:

1. Këshillim.

2. Gjobë.

3. Përrjashtim i përkohshëm nga Urdhri i Mjekëve për një kohë të caktuar që zgjat deri në 5 vjet.

Veç këtyre si masë plotësuese komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese. Në rastin e përrjashtimit të përkohshëm i ndëshkuari nuk mund të ripranohet si anëtar pa plotësuar këto masa.

Ai që dënohet me përrjashtim të përkohshëm nga Urdhri i Mjekëve, ka të drejtë të ankohet në këshillin kombëtar brenda 30 ditëve pas marrjes së vendimit të komisionit disiplinor.

Seanca e apelimit mbahet brenda 60 ditëve, duke filluar nga data që ankesa është marrë nga këshilli kombëtar. Në apelim mund të paraqiten fakte të tjera të reja. Në këtë seancë anëtari ka të drejtë të paraqitet para këshillit kombëtar dhe të argumentojë mendimin e vet.

Ankimi nuk e pezullon vendimin e përrjashtimit të përkohshëm. Vendimi i këshillit kombëtar është i formës së prerë.

Neni 7

Ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit ngarkohet të ngrejë një komision të përkohshëm, detyra e të cilit është të organizojë zgjedhjet e para të këshillit kombëtar.

Këto zgjedhje do të bëhen brenda 100 ditëve nga data që ky ligj hyn në fuqi. Me zgjedhjen e këshillit kombëtar, komisioni i përkohshëm shkrihet automatikisht.

Neni 8

Të gjitha aktet që rregullojnë mënyrën e organizimit, strukturën, procedurat e zgjedhjeve dhe emërimeve, detyrat ose përgjegjësitë e organeve drejtuese të Urdhrit të Mjekëve, propozohen nga këshilli kombëtar i Urdhrit të Mjekëve dhe miratohen nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.549, datë 5.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.